

ANUAR ME:

CEPTED ON:

ALJENO:

Br.



Bordi I Drejtorëve të NPK "Stacioni i Autobusëve", Sh.A. Malishevë

Në përputhje me nenin 16, 17 të Ligjit nr. 03/L-087 për "Ndermarrjet Publike" dhe në bazë të dispozitave të nenit 21 paragrafi 21.3, të Ligjit nr. 03/L-87 mbi Ndërmarrjet publike, respektivisht dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet publike me date 30 maj 2012, Bordi i Drejtorëve të NPK "Stacioni i Autobusëve", Sh.A. Malishevë në mbledhjen e mbajtur me datë, 30.06.2022, sh.pallë:

KONKURS

Pozita: Kryeshef Ekzekutiv i NPK "Stacioni i Autobusëve", Sh.A. Malishevë

Numri i Pozitave : 1 (një)

Kohëzgjatja e mandatit: 3 (tre) vite

Vëndi i Punës: Malishevë

Orari i punës: I plotë

DETYRAT DHE PERGJEGJESITE:

- Kryeshefi ekzekutiv i ndërmarrjes (KE), ka autoritet që të lidhë kontratë për ndërmarrjen, në pajtueshmëri me Ligjin, Statutin, dhe aktet tjera qeverisëse, përjashtuar rastet e parapara me dispozitat e nenit 192, paragrafi 192.1 pika c, të Ligjit për shoqëritë tregtare;
- Organizimi i kompanisë bëhet në mbikëqyrjen dhe përgjegjësinë e KE-së, në

- pajtueshmëri me Statutin dhe aktet të tjera të ndërmarrjes dhe vendimeve të Bordit të drejtorëve. Të gjitha çështjet në lidhjen me ndërmarrjen, të cilat nuk janë përgjegjësi e Komisionit komunal të aksionerëve, të Bordit të drejtorëve, Komisionit të auditimit / zyrtarit të auditimit të brendshëm, do të vendosen me përgjegjësi të kryeshefit ekzekutiv;
- c. Kryeshefi ekzekutiv do të ketë autoritet të punësojë apo të largojë nga puna zyrtarët dhe stafin e ndërmarrjes, përveç zyrtarëve të cilët zgjidhen nga Bordi i drejtorëve apo Komisioni i auditimit;
 - d. Këshillon dhe merr pjesë në Bordin e drejtorëve, në përcaktimin e strategjisë së ndërmarrjes, si dhe planet e saj strategjike afatgjata;
 - e. I propozon Bordit të drejtorëve kandidatë të përshtatshëm për emrim, si zyrtari kryesor i financave dhe thesarit dhe sekretarit;
 - f. I ofron Bordit të drejtorëve, kurdo që të jetë e nevojshme dhe, së paku një herë në muaj, raporte për transaksionet kryesore të ndërmarra dhe për vendimet kryesore të marra nga menaxhmenti në lidhje me udhëheqjen e veprimtarisë së ndërmarrjes;
 - g. I dorëzon Bordit të drejtorëve, në përgjegjësin e tij/saj, dokumente, letra e informacione në lidhje me të gjitha çështjet e përfshira në agjendën e mbledhjeve të tij;
 - h. Bën matjen e performancës së ndërmarrjes, dhe i ofron Bordit rregullisht, së paku çdo tre muaj, raportet e matjes së performancës së ndërmarrjes ndaj klientëve të saj;
 - i. Themelon dhe rishikon strukturën e organizatave të kompanisë, dhe alokimin e fuqisë vendimarrëse të ndërmarrjes, si dhe të fuqisë së ndërlidhjes në mes të udhëheqësve dhe të punësuarve në ndërmarrje;
 - j. I ofron Komisionit të auditimit të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohej;
 - k. I ofron zyrtarit të auditimit të brendshëm të gjitha informatat dhe asistencën që mund të kërkohej nga ky i fundit;

1. I kryen detyrat dhe punët e tjera të caktuara me ligjet në fuqi.

KUALIFIKIMET DHE AFTESITE:

Kandidatët e suksesshëm për pozitën e Kryeshef Ekzekutiv i NPK "Stacioni i Autobusëve", Sh.A. Malishevë, duhet të plotësojnë kushtet e kualifikimit. pavarësisë dhe përshtatshmërisë profesionale. si vijon:

- Diploma e fakultetit dhe trajnime tjera relevante.
- Përvojë pune 5-vjeçare
- Të jetë person me integritet të dëshmuar i cili plotëson kushtet e parapara me dispozitat e nenit 17.1, 17.2, 17.3, 17.5, të Ligjit nr. 03/L-87. për Ndermarrjet Publike, gjegjësisht Ligjit mbi ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087, për Ndermarrjet Publike i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 si dhe me Ligjin nr. 05/L-009.
- Njohuri kompjuterike.

MENYRA E VLERESIMIT TE KANDIDATEVE:

- Testi me shkrim
- Testi me gojë (intervista)

KUSHTET TJERA:

Kandidatët e suksesshëm për pozitën, Kryeshef Ekzekutiv i NPK "Stacioni i Autobusëve", Sh.A. Malishevë, duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- CV-në
- Letër motivimin
- Diplomen e përgatitjes shkollore
- Dëshminë për përvojën e punës
- Deklaratën nën betim në të cilën deklaron ai/ajo se i përmbush kushtet e kualifikimit, pavarësisë dhe ato të përshtatshmërisë profesionale sipas paragrafit 1-3 të nenit 17. të Ligjit për Ndërmarrjet Publike(formular i cili plotësohet në momentin e dorëzimit të dokumentacionit)
- Dokumentacionet e parapara në kushtet e punësimit (dëshmitë e kualifikimit profesional, përvojës së punës)
- Certifikatën që dëshmon se nuk është nën hetime dhe denuar për vepra penale sipas nenit 17 të Ligjit nr. 03/L-087. për Ndermarrjet Publike

- Kopje të Leternjoftimit ose Pasaportes se Republikës së Kosovës (që dëshmon se është shtetas i Republikës së Kosovës)

DORËZIMI I APLIKACIONIT:

- Dokumentacioni duhet të jetë në pliko të mbyllur, ku shkruhet, Emri dhe Mbiemri i aplikantit, e-maili, numri i telefonit, emri i NPK-së dhe të dorëzohet pranë zyra të NPK "Stacioni i Autobusëve", Sh.A. Malishevë. rruga ..Adem Jashari... (përballe Stacionit të Policisë).
- Dokumentacioni i dorëzuar nuk kthehet. Dokumentet origjinale mund të kërkojnë gjatë intervistës.

Vërejtje: Aplikacionet e arritura pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të merren në shqyrtim nga ana e Bordit të Drejtorëve të NPK "Stacioni i Autobusëve", Sh.A. Malishevë.

Do të kontaktohen vetëm personat e përzgjedhur për intervistë.

KOMPENSIMI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV I NPK "STACIONI I AUTOBUSËVE", SH.A. MALISHEVË:

Kompenzimi i Kryeshefit Ekzekutiv i NPK "Stacioni i Autobusëve", SH.A. Malishevë bëhet në bazë të nenit 20 të Ligjit për Ndermarrje Publike dhe nenit 12 të Ligjit nr. 04/L-111. për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-087. për Ndermarrjet Publike.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e publikimit.
Dorëzimi i aplikacioneve bëhet nga dt: 30.06.2022 deri me 14.07.2022.

Bordi i Drejtorëve të NPK "Stacioni i Autobusëve", Sh.A. Malishevë:

Nexhmedin Shurdhaj Nshurdhaj

Agron Zogaj Zogaj

Mirë lindë Ademaj MADEMaj

Gëzim Morina GMorina

